



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 25.2.2025

Nr: 162

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BASHKIMIT PËR
TË DREJTAT E NJERIUT”, ME KRYETAR Z. VANGJEL DULE, PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË
DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1145 prot., datë 20.2.2025, me:

- KËRKUES:** Partia politike “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me kryetar Z. Vangjel Dule
- OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
- BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Data: 25.2.2025 Nr: 162
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me kryetar Z. Vangjel Dule, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

“Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Vangjel Dule, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 19.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me initiale “PBDNJ”, me Kryetar Z. Vangjel Dule, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” me shkronja nistore “PBDNJ”, me adresë: Rruga "Norbert Jokl", përballë ish ATSH, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Vangjel Dule, me adresë: Selia e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Elona Boçi, me adresë: Rruga "Norbert Jokl", përballë ish ATSH, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Thodhori Kamberi, dhe Zj. Elena Muho, me adresë: Rruga "Norbert Jokl", përballë ish ATSH, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e

dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me kryetar Z. Vangjel Dule, me shkronjat nistore “PBDNJ”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI